

Statut i përditësuar

STATUT

**I SHOQËRISË AKSIONARE
"luteCredit Albania" SH.A.**

KREU I

**EMRI, FORMA E SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI,
KOHËZGJATJA**

NENI 1

Themelimi

- 1.1. Emri i shoqërisë është "luteCredit Albania" Sh.A. ("**Shoqëria**"), e themeluar si një shoqëri aksionare me një sistem me dy nivele drejtimi në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.
- 1.2. Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 1.3. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe këtë Statut.

NENI 2

Selia

- 2.1. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: "Rruga "Andon Zako Çajupi", Njësia Administrative Nr. 5, Ndërtesa Nr. 3, Hyrja 2, Zona Kadastrale 8270, Nr. Pasurie 2/462-N3, Vol 38, Fq. 139".
- 2.2. Shoqëria mund të themelojë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose në

Updated Bylaws

BYLAWS

**OF THE JOINT STOCK COMPANY
"luteCredit Albania" SH.A.**

CHAPTER I

**NAME, FORM OF THE COMPANY, LEGAL SEAT,
OBJECT, DURATION**

ARTICLE 1

Incorporation

- 1.1 The name of the company is "luteCredit Albania" SH.A. (hereinafter referred to as the "**Company**"), incorporated in the form of a joint stock company with two tiers administration system, in accordance with the Albanian law.
- 1.2 The Company acquires legal personality upon registration with the National Business Center.
- 1.3 The Company shall exercise its activity in accordance with the Albanian legislation and this Bylaws

ARTICLE 2

Legal Seat

- 2.1 The legal seat of the Company is located at the address: "Andon Zako Çajupi" Street, Municipality Unit No .5, Building No. 3, Entrance no. 2, Cadastral Area 8270, Property No. 2462-N3, Vol 38, Pg. 139".
- 2.2 The Company may establish branches, or representative offices within the territory of the Republic of Albania and/or outside



<p>shtete të tjerë, në përputhje me ligjin e zbatueshëm dhe Statutin.</p>	<p>Albania, in accordance with the applicable laws and the Bylaws.</p>
<p style="text-align: center;">NENI 3 Objekti</p> <p>3.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë:</p> <p>i. Dhënien e kredive si dhe çdo veprimtari tregtare dhe financiare të lidhur me kredidhënien;</p> <p>ii. Për qëllim të realizimit të objektit të më mësipërm, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të ligjshëm që lidhet me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, dhënie me qira, vënie të hipotekave, pengjeve, barrëve siguroese, apo çfarëdolloj mjeti tjetër garancie, që mund të konsiderohen të nevojshëm;</p> <p>iii. Çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm ose i domosdoshëm për realizimin e qëllimeve dhe objektit të Shoqërisë, si edhe çdo aktivitet tjetër të ligjshëm.</p> <p>3.2 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj pas marrjes dhe në përputhje me licencat apo lejet përkatëse.</p>	<p style="text-align: center;">ARTICLE 3 Object</p> <p>3.1 The Company object shall be the following:</p> <p>i. Provision of loans, as well as any other commercial and financial activity related to the lending activity therein;</p> <p>ii. For purposes of completing the above object, the Company may perform any legal activity related to movable or immovable properties, as well as any commercial and financial activity, lease, placement of mortgages, pledges, security charges or any other guarantee as it may be deemed fit and necessary;</p> <p>iii. Any other activity that may be deemed useful or necessary for the completion of the object of the Company, as well as any other lawful business activity.</p> <p>3.2 The Company shall perform its activity upon receipt and in full compliance with the relevant licenses and permits</p>
<p style="text-align: center;">NENI 4 Kohëzgjatja</p> <p>4.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit.</p> <p>4.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë në çdo kohë të ndryshojë kohëzgjatjen e Shoqërisë.</p>	<p style="text-align: center;">ARTICLE 4 Duration</p> <p>4.1 The duration of the Company shall be for an indefinite period of time, as of the registration date.</p> <p>4.2 The General Meeting may decide to amend the duration of the Company at any time.</p>

**KREU II
KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET,
AKSIONET
NENI 5**

Kapitali, Aksionet dhe Aksionarët

- 5.1 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 65.000.000 (gjashtëdhjetë e pesë milion) Lekë, i ndarë në 65.000 aksione me vlerë nominale 1.000 (një mijë) Lekë secili.
- 5.2 Aksionet e mësipërme zotërohen nga aksionari i vetëm "AS luteCredit Europe", shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit estonez, regjistruar në Regjistrin Tregtare të Estonisë, me numër 11551447, me seli në adresën Harju maakond, Talin, Kesklinna linnaosa, Rotermani tn 5-26, 10111.

**CHAPTER II
SHARE CAPITAL, CONTRIBUTIONS, SHARES**

**ARTICLE 5
Share Capital, Shares and the Shareholders**

- 5.1 The registered share capital of the Company is 65.000.000 (sixty-five millions) Albanian Lek, divided in 65.000 shares with a par value of 1.000 (one thousand) ALL each.
- 5.2 The above shares are held and owned by the sole shareholder "AS luteCredit Europe", a joint stock company established in accordance with the Estonian legislation, registered with the Estonian Commercial Register, with number 11551447 with legal seat at the address Harju maakond, Tallinn, Kesklinna linnaosa, Rotermanni tn 5-26, 10111.

**NENI 6
Aksionet**

- 6.1 Aksionet janë nominale dhe regjistrohen në Regjistrin e Aksioneve i cili duhet të përmbajë të dhënat e zotëruesve të aksioneve të Shoqërisë si: emri e mbiemri i aksionarit, apo emri i regjistruar nëse është person juridik, vlera nominale e aksionit, adresa e banimit apo zyra qendrore e aksionarit dhe data e kryerjes së regjistrimit. Administratori është përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Aksioneve.
- 6.2 Çdo Aksion përfaqëson një votë.
- 6.3 Çdo Aksion i jep mbajtësit të tij të drejtën për të përfituar pjesë të fitimeve të Shoqërisë në përputhje me pjesëmarrjen

**ARTICLE 6
The Shares**

- 6.1 The shares of the Company are nominal shares and registered with the Register of the Shares, which must include the data of the holders and owner of the Company namely: name and surname of the shareholder, or the registered name in case of a legal entity, the par value of the share, the address or the legal seat of the shareholder, and date of registration. The administrator shall be responsible for keeping the Register of the Shares.
- 6.2 Each share represents one vote.
- 6.3 Each share entitles the owner to take part in the profit of the Company in accordance with their respective participation and in



<p>përkatëse dhe në rast të likuidimit të drejtën për aktivet e mbetura të Shoqërisë.</p>	<p>case of liquidation it represents the right in the remaining active of the Company.</p>
<p style="text-align: center;">NENI 7 Transferimi i Aksioneve</p> <p>7.1 Aksionet mund t'i transferohen çdo pale të tretë, me kusht që Aksionari transferues t'i ketë njoftuar më parë me shkrim Aksionarët e tjerë të paktën 3 (tre) muaj para ("Periudha e Njoftimit") numrin e aksioneve për t'u shitur, çmimin e shitjes, identifikimin e palës së tretë dhe çdo kusht tjetër lidhur me transferimin e aksionit. Aksionarët e tjerë duhet t'i përgjigjen njoftimit të Aksionarit transferues nëse dëshirojnë të blejnë aksionet sipas termave dhe kushteve të vendosura në njoftim brenda Periudhës së Njoftimit. Në rast të një përgjigje negative ose nëse Periudha e Njoftimit kalon pa përgjigje, Aksionari transferues mund të procedojë me transferimin e aksionit tek pala e tretë.</p> <p>7.2 Transferimi i pronësisë së aksioneve është i vlefshëm me nënshkrimin e kontratës së shitjes pa u kushtëzuar nga kryerja e formaliteteve për regjistrimin dhe publikimin e kontratës së shitjes.</p> <p>7.3 Kushtet e parashikuara më sipër në lidhje me njoftimin për të ushtruar të drejtën e parablerjes nuk do të zbatohen në rast të transferimit të aksioneve tek një shoqëri e cila kontrollohet nga aksionari transferues ose në rast të transferimit të aksioneve tek pasardhësit e drejtpërdrejtë ose tek paraardhësit apo tek bashkëshortët.</p> <p>7.4 Transferimi i aksioneve, si dhe krijimi ose transferimi i çdo të drejte tjetër duhet të</p>	<p style="text-align: center;">ARTICLE 7 Transfer of Shares</p> <p>7.1 The Shares may be transferred to any third party provided that the transferring Shareholder has notified in writing the other Shareholders at least 3 (three) months in advance (the "Pre-emption Right Notification Period") on the number of the shares to be sold, the selling price, identification of the third party and any other terms and conditions related to the transfer of the shares. The other Shareholders must reply to the Pre-emption Right Notification whether they wish to purchase the shares under the terms and conditions set forth therein within the Pre-emption Right Notification Period. In case of a negative reply or the Pre-emption Right Notification Period passes unobserved, the transferring Shareholder may precede with the transfer of the shares to the third party.</p> <p>7.2 The Share transfer shall be valid upon signature of the sale-purchase agreement without being subject to fulfillment of the formalities for registration and publication of the sales-purchase contract.</p> <p>7.3 The conditions stipulated above on the Pre-emption Right shall not apply in case of transfer of the shares to a company which is controlled by the transferring shareholder or in case of transfer of the shares to the direct descendants or ascendants or to the spouse.</p> <p>7.4 The transfer of the shares, as well as the</p>

<p>regjistrohen në regjistrin e aksioneve.</p>	<p>creating or the transfer of any other rights should be registered with the register of the shares.</p>
<p style="text-align: center;">NENI 8</p> <p style="text-align: center;">Llojet e Aksioneve, Obligacioneve, Të Drejtave dhe Kufizimet</p> <p>8.1 Pa cenuar të drejtat që rrjedhin nga aksionet ekzistuese, aksionet e reja mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me një shumicë prej $\frac{3}{4}$ të votave të aksionarëve të pranishëm, me kusht që të jetë arritur kuorumi i parashikuar më poshtë në paragrafin 14.1.</p> <p>8.2 Asambleja e Përgjithshme, me të njëjtën shumicë të parashikuar më sipër mund të vendosë emetimin e obligacioneve të cilat u garantojnë zotëruesve të tyre të drejtën për t'i kthyer në aksione ose të drejtën e parablerjes për aksionet e reja si dhe emetimin e obligacionet që bëjnë të mundur pjesëmarrjen e zotëruesve të tyre në ndarjen e fitimeve në dobi të aksionarëve.</p>	<p style="text-align: center;">ARTICLE 8</p> <p style="text-align: center;">Type of Shares, Bonds, Right and Limitations</p> <p>8.1 Without prejudice to the rights related to the existing shares, new shares may be issued with rights and limitation as determined in the resolution of the General Meeting approved by the majority of $\frac{3}{4}$ of the votes of the shareholders present at the meeting, provided that the quorum required for by paragraph 14.1 below is met.</p> <p>8.2 The General Meeting, with the same majority as the one stipulated above, may approve the issuance of bonds which grant to the respective holders the right to convert such bonds into shares, or the pre-emption right for issued shares, as well as the issuance of bonds enabling the respective holders to participate in the distribution of profits.</p>
<p style="text-align: center;">NENI 9</p> <p style="text-align: center;">Certifikatat e Aksioneve</p> <p>9.1 Secili aksionar, që zotëron aksione, ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për të gjitha aksionet e çdo klase të zotëruara nga ai, me pagesën e një shume të përcaktuar nga Asambleja e Përgjithshme.</p> <p>9.2 Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për aksionet e zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorëzimi i certifikatës përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të aksioneve do</p>	<p style="text-align: center;">ARTICLE 9</p> <p style="text-align: center;">Certificates of the Shares</p> <p>9.1 Each of the shareholders is entitled to have a certificate for all the shares of each class, upon payment of the fee determined by the General Meeting.</p> <p>9.2 The Company is not obliged to issue more than one certificate for the shares jointly owned by several persons; the certificate shall be deemed delivered to all joint owners in case it is delivered to their representative. The names of the joint</p>

<p>të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të aksioneve. Emrat e zotëruesve të përbashkët të aksioneve do të renditen në certifikatën e aksionit.</p>	<p>owners must be listed in the certificate.</p>
<p style="text-align: center;">NENI 10</p> <p>Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar</p> <p>10.1 Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit duhet të miratohet me shumicën e kualifikuar prej $\frac{3}{4}$ të votave të aksionarëve pjesëmarrës në votim me kusht që të plotësohet kuorumi i kërkuar nga paragrafi 14.1 më poshtë.</p> <p>10.2 Kapitali i regjistruar mund të zmadhohet sipas mënyrave të parashikuara në ligj por ne çdo rast, kapitali i regjistruar nuk mund të zmadhohet nëse nuk janë shlyer kontributet për aksionet e nënshkuara më parë.</p> <p>10.3 Kur emetohen aksione të reja, aksionarët ekzistues kanë të drejtën e parablerjes së aksioneve të reja në përputhje me pjesëmarrjen e tyre në kapital dhe sipas procedurës së parashikuar nga ligji.</p> <p>10.4 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë sipas mënyrave të parashikuara në ligj, por në çdo rast zvogëlimi prek aksionarët në mënyre proporcionale me pjesëmarrjen e tyre në kapital.</p>	<p style="text-align: center;">ARTICLE 10</p> <p>Increase and Decrease of the Share Capital</p> <p>10.1 The increase or decrease of the share capital must be approved by the General Meeting with a qualified majority of $\frac{3}{4}$ of the voting shares present in the meeting, provided that the quorum required for by paragraph 14.1 below is met.</p> <p>10.2 The share capital may be increased as provided for by the applicable law, provided, however, that the share capital may not be increased in case the previously issued and subscribed shares are not entirely paid up.</p> <p>10.3 In case of issuance of new shares, the existing shareholders have the pre-emption right to subscribe the newly issued shares in proportion with their participation in the share capital and in compliance with the procedure stipulated by the law.</p> <p>10.4 The General Meeting may decrease the share capital as provided for by the applicable law, provided, however, that such decrease shall affect the shareholders proportionally with their participation in the share capital.</p>

<p style="text-align: center;">KREU III ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË</p> <p style="text-align: center;">NENI 11 Organet Drejtuese të Shoqërisë</p> <p>11.1 Organet Drejtuese të Shoqërisë janë: i.Asambleja e Përgjithshme; ii.Këshilli Mbikqyrës; iii.Administratori.</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER III GOVERNING BODIES OF THE COMPANY</p> <p style="text-align: center;">ARTICLE 11 The Governing Bodies of the Company</p> <p>11.1 The governing bodies of the Company are: i. The General Meeting; ii. The Supervisory Council; iii. The Administrator.</p>
<p style="text-align: center;">ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME</p> <p style="text-align: center;">NENI 12 Asambleja e Përgjithshme</p> <p>12.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë dhe përbëhet nga të gjithë aksionarët e Shoqërisë. Çdo aksionar ka të drejtën të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, të shprehë mendimin e tij dhe të votojë në përputhje me aksionet që zotëron.</p>	<p style="text-align: center;">GENERAL MEETING</p> <p style="text-align: center;">ARTICLE 12 General Meeting</p> <p>12.1 The General Meeting represents the highest decision-making body of the Company and is composed of all the shareholders. Each of the shareholders is entitled to participate in the General Meeting and to express their opinion and to vote in accordance with the shares they hold and own.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 13 Mënyrat e Thirrjes, Përfaqësimi dhe Procesverbali i Mbledhjes</p> <p>13.1 Mënyrat e thirrjes 13.1.1 Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori ose nga Këshilli Mbikëqyrës në rastet e parashikuar në ligj sa herë që konsiderohet e nevojshme për interesat e Shoqërisë si dhe nga aksionarët të cilët zotërojnë të paktën 5% (pesë për qind) të kapitalit. Në çdo</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 Convocation, Representation and Minutes of the Meetings</p> <p>13.1 Convocation 13.1.1 The General Meeting is convoked by the Administrator, or the Supervisory Council as stipulated by the law whenever it is deemed necessary for the interests of the Company, or by the shareholders holding at least 5% of the share capital. In any case the General</p>

<p>rast, Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret të paktën një herë në vit, brenda muajit Qershor, me qëllim diskutimin dhe miratimin e bilancit vjetor të vitit ushtrimor të mëparshëm.</p> <p>13.1.2 Asambleja e Përgjithshme mund të mbledhet në një vendndodhje të ndryshme nga selia e Shoqërisë.</p> <p>13.1.3 Njoftimi për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet me letër rekomande me njoftim marrjeje, të dërguar në adresën e aksionarëve të regjistruar në Regjistrin e Aksioneve, ose me postë elektronike në adresën elektronike të aksionarëve, jo më vonë se 21 (njëzet e një) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë.</p> <p>13.1.4 Njoftimi për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, orën dhe datën e mbledhjes, si dhe procedurat e detajuara të pjesëmarrjes dhe të votimit, informacion mbi vendin dhe mënyrat e marrjes së dokumentacionit dhe projekt vendimeve të Asamblesë si dhe elementet e tjerë të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.</p> <p>13.1.5 Asambleja e Përgjithshme do të quhet e thirrur dhe e mbledhur rregullisht edhe nëse nuk respektohen të gjitha formalitetet e thirrjes, nëse të gjithë aksionarët që përfaqësojnë të tërë kapitalin e Shoqërisë janë të pranishëm në mbledhje dhe shprehen dakord për të zhvilluar mbledhjen e asamblesë.</p> <p>13.1.6 Në rast se pjesëmarrësit e takimit ndodhen në vende të ndryshme, Asambleja e Përgjithshme mund të mbahet nëpërmjet telekonferencës ose video konferencës ose çdo mjeti tjetër të</p>	<p>Meeting should be convoked at least once a year within the month of June of each calendar year in order to discuss and approve the financial statements of the previous financial year.</p> <p>13.1.2 The General Meeting may be convened in a place other than the legal seat of the Company.</p> <p>13.1.3 The notification for the convocation of the General Meeting should be sent with registered mail, delivered to the address of the shareholders as registered in the Register of Shares or by e-mail to the email address of the shareholders, at least 21 (twenty one) days prior to the date of the meeting.</p> <p>13.1.4 The notification for the convocation of the General Meeting should provide the agenda, the place, time and date of the meeting, as well as the detailed participation and voting procedures, information on the place and method for obtaining the documents and draft resolutions of the General Meeting and any other element as stipulated by the applicable law.</p> <p>13.1.5 Irrespective of irregularities in the procedural requirements mentioned above, the General Meeting shall be deemed duly convened in case the shareholders representing the entire share capital of the Company are present and agree to hold the meeting.</p> <p>13.1.6 In case the participants to the meeting are located in different places, the General Meeting may be held through teleconference or video conference, or any other telecommunication mean, provided, however, that the participants are identifiable and are able to follow</p>
--	--

telekomunikimit, me kusht që pjesëmarrësit të jenë të identifikueshëm dhe të jenë në gjendje të ndjekin diskutimet, në mënyrë që të marrin pjesë dhe të shkëmbejnë dokumente.

13.2 Përfaqësimi

13.2.1 Çdo aksionar mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme nga një person tjetër në bazë të një prokure me shkrim. Në çdo rast, prokura mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme dhe është e vlefshme për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

13.3.1 Administratorët dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të Aksionarëve në Asamblenë e Përgjithshme.

13.3 Procesverbali i Mbledhjes

13.3.1 Asambleja e Përgjithshme drejtohet nga kryetari i Këshillit Mbikëqyrës, në rast mungese ose pamundësie të tij, Asambleja e Përgjithshme drejtohet nga Nën-kryetari i Këshillit Mbikëqyrës, nëse ka, dhe në rast mungese ose pamundësie të këtij të fundit, Asambleja e Përgjithshme drejtohet nga një aksionar i emëruar nga aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar në mbledhje. Asambleja e Përgjithshme emëron një sekretar, i cili mund të mos jetë domosdoshmërisht një prej aksionarëve.

13.3.2 Kryetari i mbledhjes ka kompetenca të plota për të kontrolluar prokurat, të drejtën e aksionarëve dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, dhe për të përcaktuar nëse Asambleja është mbledhur rregullisht dhe nëse është arritur kuorumi i domosdoshëm për të marrë

the discussions, in order to participate and to exchange documents.

13.2 Representation

13.2.1 Each of the shareholders may be represented in the General Meeting by a third party duly authorized by virtue of a power of attorney. The power of attorney may be issued only for one meeting of the General Meeting and shall remain valid for further meetings with the same agenda.

13.3.1 The Administrators or the members of the Supervisory Council may not represent the Shareholders at the General Meeting.

13.3 Minutes of Meeting

13.3.1 The General Meeting is chaired by the chairman of the Supervisory Council, or, in case of the latter absence, by the vice-chairman of the Supervisory Council, if any, or, in case of the latter's absence or unavailability, by any of the shareholders appointed by the shareholders present in the meeting. The General Meeting appoints a secretary of the meeting; the latter is not required to be one of the shareholders.

13.3.2 The chairman of the General Meeting is entitled to review the power of attorneys, the right for participation of the shareholders or their representatives in the meeting, as well as to determine whether the meeting is duly convoked and if the quorum required for resolving valid decisions has been reached. The chairman is entitled to lead the discussions and to determine the voting method and procedures.

13.3.3 The decision, minutes and the list of participants shall be prepared upon

<p>vendime të vlefshme. Kryetari ka gjithashtu të drejtën për të drejtuar diskutimet dhe përcaktuar metodat dhe procedurat e votimit.</p> <p>13.3.3 Vendimet, procesverbalet dhe lista e pjesëmarrësve do të përgatiten pas çdo asambleje dhe do të nënshkruhet nga të paktën kryetari i asamblesë. Administratori i Shoqërisë është përgjegjës për ruajtjen e procesverbalit.</p> <p>13.3.4 Në rast se Shoqëria zotërohet nga një aksionar, të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve në të kundërt ato do të jenë absolutisht të pavlefshme.</p>	<p>termination of the meeting and must be signed by at least the Chairman. The Administrator of the Company is responsible for the safeguarding of the minutes.</p> <p>13.4.3 In case the share capital of the Company is entirely held and owned by a Sole Shareholder, all decisions taken by the latter must be entered into a decision register otherwise they shall be deemed null and void.</p>
<p style="text-align: center;">NENI 14</p> <p style="text-align: center;">Kuorumi, Shumica dhe Kompetencat e Asambleja e Përgjithshme</p> <p>14.1 Asambleja e Përgjithshme, për çështje të cilat vendosen me $\frac{3}{4}$ e votave të aksionarëve, mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm më shumë se 50 për qind e aksioneve me të drejtë vote.</p> <p>14.2 Asambleja e Përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ për çështjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> i. Ndryshime të Statutit; ii. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit; iii. Shpërndarjen e fitimeve vjetore; iv. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë; <p>14.3 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme për çështje të cilat vendosen me shumicë të thjeshtë vetëm nëse janë të pranishëm aksionarët që zotërojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve me të drejtë vote.</p> <p>14.4 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund</p>	<p style="text-align: center;">ARTICLE 14</p> <p style="text-align: center;">The Quorum, Majority and the Competence of the General Meeting</p> <p>14.1 Whenever the majority required for taking valid decision by the General Meeting is of $\frac{3}{4}$ of the voting shares present in the meeting, the quorum required for the General Meeting to take valid decision shall be the presence of more than 50% of the total number of voting shares of the Company.</p> <p>14.2 The General Meeting resolves with a three-quarter majority vote on the following issues:</p> <ul style="list-style-type: none"> i. Amendments of these Bylaws; ii. Increase or decrease of the share capital of the Company; iii. Distribution of profits, dividends; iv. Restructuring of the Company or its dissolution. <p>14.3 In case of matters requiring simple majority vote of the voting shares</p>

<p>të mbliidhet për shkak të mungesës së këtij kuorumi, Asambleja duhet të mbliidhet përsëri, me të njëjtin rend dite, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas thirrjes së parë.</p> <p>14.5 Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicë të thjeshtë për çështjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> i. Përcaktimin e politikave tregtare; ii. Emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; iii. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; iv. Çdo çështje tjetër të parashikuara shprehimisht nga ligji dhe statuti. 	<p>present in the meeting, the quorum required for the General Meeting to take valid decision shall be the presence of more than 30% of the total number of voting shares of the Company.</p> <p>14.4 In case the General Meeting may not be held due to lack of the quorum, the meeting shall be convened once again with the same proposed agenda within 30 days from the date scheduled for the first convoked meeting.</p> <p>14.5 The General Meeting resolves with simple majority vote of the voting shares present in the meeting on the following issues:</p> <ul style="list-style-type: none"> i. Approval of the commercial and business policies of the Company; ii. Appointment and dismissal of the members of the Supervisory Council, the liquidator(s) and the chartered accountant; iii. Approval of annual financial statements and performance reports; iv. Any other issues expressly provided for by law or these Bylaws.
<p style="text-align: center;">KËSHILLI MBIKËQYRËS</p> <p style="text-align: center;">NENI 15</p> <p style="text-align: center;">Këshilli Mbikëqyrës</p> <p>15.1 Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga jo më pak se tre (3) anëtarë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, për një afat tre (3) vjeçar.</p> <p>15.2 Nuk mund të zgjidhen anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës administratorët e Shoqërisë,</p>	<p style="text-align: center;">SUPERVISORY COUNCIL</p> <p style="text-align: center;">ARTICLE 15</p> <p style="text-align: center;">Supervisory Council</p> <p>15.1 The Supervisory Council is composed of not less than three (3) members appointed by the General Meeting by simple majority vote of the voting shares present in the meeting for a mandate of three (3) years.</p> <p>15.2 The Administrator(s) of the Company, the administrators of companies of the</p>

administratorët e shoqërive të tjera të të njëjtit grup, si dhe personat e lidhur me to.

15.3 Këshilli Mbikëqyrës, me shumicë të thjeshtë emëron midis anëtarëve të tij, Kryetarin dhe Nënkryetarin.

15.4 Personat e mëposhtëm emërohen si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës:

– **Tarmo Sild**, atësia Juri, qytetar Estonez, Lindur në Esti, më 13.10.1975, me banim në Talin, mbajtës i Pasaportës Nr. KD0106078, Nr. Personal 37510135211, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës me afat vlefshmërie mandati nga data 02.11.2018 deri më datë 02.11.2021

– **Allar Niinepuu**, atësia Jaan, qytetar Estonez, Lindur në Esti, në 17.01.1973, me banim në Talin, mbajtës i pasaportës me nr. KD0121860, Nr. Personal 37301170260, në cilësinë e anëtarit nga data 02.11.2018 me afat vlefshmërie mandati deri më datë 02.11.2021

– **Kristel Kurvits**, atësia Enn, qytetare Estoneze, lindur më 02.06.1972, në Estoni dhe banues në Magasini 29-3 Tallinn 10138, Estoni, mbajtëse e pasaportës me nr. KE0202455 dhe nr. personal 47206025728 në cilësinë e anëtares të Këshillit Mbikëqyrës me afat vlefshmërie mandati nga data 01.11.2018 deri më datë 02.11.2021

same group of companies, as well as persons related to them may not be appointed as members of Supervisory Council.

15.3 The Supervisory Council, by simple majority vote, appoints among its members, the Chairman and the Vice-Chairman.

15.4 The following persons are appointed as members of the Supervisory Council:

- **Tarmo Sild**, son of Juri, citizen of the Republic of Estonia, born in Estonia, on 13.10.1975, resident in Tallinn, holder of the Passport No. KD0106078 and Personal No.37510135211, in the capacity of the Chairman of the Supervisory Council with a valid mandate from 02.11.2018 until 02.11.2021.

- **Allar Niinepuu**, son of Jaan, citizen of the Republic of Estonia, born in Estonia, on 17.01.1973, resident in Tallinn, holder of the Passport No.KD0121860 and Personal No.37301170260, in the capacity of the member of the Supervisory Council from date 02.11.2018 until 02.11.2021.

- **Kristel Kurvits**, daughter of Enn, Estonian citizen, born on 02.06.1972, in Estonia and resident in Magasini 29-3, Tallinn 10138, Estonia, holder of the passport no. KE0202455 with personal No. 47206025728 in the capacity of the member of the Supervisory Council for a 3 years period starting from 02.11.2018 until 02.11.2021.

NENI 16**Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës**

- 16.1 Mënyrat e Thirrjes**
- 16.1.1 Këshilli Mbikëqyrës mund të thirret me anë të një kërkesë me shkrim nga Kryetari i tij, dhe/ose 1/3 e anëtarëve si dhe nga Administratori i Shoqërisë duke përcaktuar datën, orën, vendin dhe rendin ditës së mbledhjes si dhe dokumentet shoqëruese.
- 16.1.2 Njoftimi mund t'i dërgohet anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës me anë të një letre rekomande, ose e-maili, të paktën 10 ditë përpara datës së mbledhjes.
- 16.1.3 Në rast se Kryetari mungon ose për ndonjë arsye nuk mund të jetë i pranishëm në mbledhje, të gjitha kompetencat e përshkruara në këtë nen i transferohen Nënkryetarit nëse ka, ose anëtarit më vjetër në detyrë të Këshillit Mbikëqyrës në mbledhje.
- 16.1.4 Këshilli Mbikëqyrës do të quhet i thirrur dhe i mbledhur rregullisht edhe nëse nuk respektohen të gjitha formalitetet e thirrjes, nëse të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë të pranishëm në mbledhje dhe shprehen dakord për të zhvilluar mbledhjen.
- 16.1.1 Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës mund të mbahet edhe me telekonferencë apo video konferencë ose me mjete të tjera elektronike të ngjashme me kusht që të gjithë të pranishmit të mund të identifikohen dhe tu jepet mundësia për të ndjekur diskutimet, për të marrë pjesë në të dhe shkëmbyer dokumentet.

ARTICLE 16**Meeting of the Supervisory Council**

- 16.1 Convocation**
- 16.1.1 The Supervisory Council may be convoked by its Chairman, and/or 1/3 of its members, and/or the Administrator of the Company, by means of a notification in writing indicating the date, time and place, agenda of the meeting and supporting documents.
- 16.1.2 The notification should be delivered by registered mail, or e-mail to the members of the Supervisory Council at least 10 days prior to the date of the meeting.
- 16.1.3 In case the Chairman is absent or for any other reason may not be present in the meeting, all the competences referred in this article shall be transferred to the vice-chairman, if any, or to the member holding such position the earliest than the other members present in the meeting.
- 16.1.4 The Supervisory Council shall be deemed duly convoked and held, irrespective of failure to observe the above procedure, in case all the members of the Supervisory Council are present in the meeting and agree to hold the meeting.
- 16.1.5 The meeting of the Supervisory Council may be held by teleconference or video conference or other similar electronic means, provided, however, that all attendees are identifiable and able to attend the discussions and exchange documents.



<p>16.2 Kuorumi dhe Shumica</p> <p>16.2.1 Këshilli Mbikëqyrës do të konsiderohet rregullisht i mbledhur nëse janë të pranishëm jo më pak se ½ e anëtarëve të tij.</p> <p>16.2.1 Këshillit Mbikëqyrës merr vendime me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Në rast barazim votash, vota e Kryetarit është vendimtare.</p> <p>16.3 Procesverbali i Mbledhjes</p> <p>16.3.1 Vendimet dhe procesverbalet do të nënshkruhen nga Kryetari , Nën-Kryetari dhe sekretari i mbledhjes.</p> <p>16.3.2 Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës mund të merret edhe me anë të një vendimi qarkullues, pa qenë e nevojshme mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës, me kusht që ky vendim qarkullues të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duke shprehur gjithashtu edhe pozicionin përkatës të secilit prej anëtarëve.</p>	<p>16.2 Quorum and majority</p> <p>16.2.1 The quorum required for the Supervisory Council to take valid decision is the presence of not less than ½ of its members.</p> <p>16.2.2 The Supervisory Council resolves with simple majority of the members present in the meeting, and, in case of tie votes, the Chairman shall have the casting vote.</p> <p>16.3 Minutes of meeting</p> <p>16.3.1 The decision and the minutes of the meeting shall be signed by the Chairman, the Vice-Chairman and the secretary of the meeting.</p> <p>16.3.2 The decision of the Supervisory Council may be approved by means of a circulating decision as well, provided, however, that such decision is signed by all the members of the Supervisory Council mentioning also their opinion on the decision.</p>
<p style="text-align: center;">NENI 17</p> <p style="text-align: center;">Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës</p> <p>17.1 Këshilli Mbikëqyrës mbikëqyr veprimtarinë e Administratorit në lidhje me zbatimin e politikave tregtare, ligjit dhe statutit.</p> <p>17.2 Këshilli Mbikëqyrës mund të vendosë të krijojë komitete të posaçme për çështje specifike. Këshilli Mbikëqyrës do të miratojë me unanimitet çdo rregullore të nevojshme për organizimin dhe funksionimin e komiteteve.</p> <p>17.3 Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës janë:</p> <p>a. Të mbikëqyrë dhe të kontrollojë</p>	<p style="text-align: center;">ARTICLE 17</p> <p style="text-align: center;">Powers of the Supervisory Council</p> <p>17.1 The Supervisory Council supervises the Administrator in relation to the implementation of the commercial policies, the law and the bylaws.</p> <p>17.2 The Supervisory Council may decide to establish special committees on specific issues. The regulation, organization and functioning of such special committees must be approved with the unanimous decision of all members of the Supervisory Council.</p>

<p>zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga Administratori;</p> <p>b. Me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme të përgatisë marrjen e masave që janë në kompetencën e kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për tu marrë si dhe të zbatojë vendimet e Asamblesë së Përgjithshme;</p> <p>c. Të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e Shoqërisë;</p> <p>d. Të kujdeset që Shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;</p> <p>e. Të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe raportet e tjera të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit të kryhen me saktësi.</p> <p>f. Të emërojë dhe të shkarkojë Administratorin si dhe të përcaktojë kompetencat ndërmjet tyre;</p> <p>g. Të përcaktojë shpërblimin e Administratorit.</p> <p>h. Çdo çështje tjetër të parashikuar në ligj.</p>	<p>17.3 The Supervisory Council has the following powers:</p> <p>a. To monitor and supervise the implementation of business policies by the Administrator;</p> <p>b. Upon request of the General Meeting, to prepare the measures which fall into the competencies of the latter, to recommend decisions to be adopted by the General Meeting and to execute the latter's decisions;</p> <p>c. To convoke the General Meeting if it is necessary for the Company's interests;</p> <p>d. To ensure that the Company complies with the law and accounting standards;</p> <p>e. To ensure that the annual financial statements, the activity performance report as well as other reports which are mandatory as per the Law or the Bylaw are accurately carried out;</p> <p>f. To appoint and dismiss the Administrator(s) and to determine their powers;</p> <p>g. To approve the salary of the Administrator;</p> <p>h. Any other issues expressly provided by law.</p>
<p style="text-align: center;">ADMINISTRATORI</p> <p style="text-align: center;">NENI 18</p> <p style="text-align: center;">Emërimi dhe shkarkimi i Administratorit</p> <p>18.1 Këshilli Mbikëqyrës emëron një ose disa persona fizik si Administrator të Shoqërisë, i cili/të cilët do të jenë përgjegjës për çështjet e përditshme të Shoqërisë sipas</p>	<p style="text-align: center;">ADMINISTRATOR</p> <p style="text-align: center;">ARTICLE 18</p> <p style="text-align: center;">The appointment and dismissal of the Administrator</p> <p>18.1 The Supervisory Council appoints one or more natural persons as the Administrator of the Company, who shall</p>

<p>kufizimeve të parashikuara nga ligji në fuqi, ky Statut dhe vendimi i Këshillit Mbikëqyrës.</p> <p>18.2 Administratori emërohet për një afat tre (3) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Mandati i Administratorit do të ripërtërihet në mënyrë të menjëhershme pas përfundimit të afatit prej 3 vite deri në mbledhjen e ardhshme të Këshillit Mbikëqyrës ku vendoset ripërtëritja e mandatit të Administratorit ose zgjedhja e Administratorit të ri.</p> <p>18.3 Administratori i Shoqërisë nuk mund të jetë në të njëjtën kohë edhe anëtar i Këshillit Mbikëqyrës.</p> <p>18.4 Administrator i shoqërisë është: Z. Akan Ajdini, shtetas shqiptar, lindur më 24.02.1979, banues në Tiranë me zotësi të plotë për të vepruar dhe juridike, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 025077518 dhe nr. personal H90224173T.</p>	<p>be responsible for the everyday business of the Company, in compliance with the limitations stipulated by the law and these Bylaws, and the decision of the Supervisory Council.</p> <p>18.2 The Administrator is appointed for a mandate of 3 years, renewable. The mandate of the Administrator shall be automatically extended upon lapse of the 3 years term until the forthcoming meeting of the Supervisory Council resolving on the renewal of the Administrator's mandate or the appointment of a new Administrator.</p> <p>18.3 The Administrator of the Company may not be a member of the Supervisory Council.</p> <p>18.4 The Administrator of the Company is: Mr. Akan Ajdini, Albanian citizen, born in 24.02.1979, resident in Tirana, with full capacity to act, holder of ID No.025077518 and personal No.H90224173T.</p>
<p style="text-align: center;">NENI 19</p> <p style="text-align: center;">Kompetencat e Administratorit</p> <p>19.1 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori.</p> <p>19.2 Administratori ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Të kryejë veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë; b. Të përfaqësojë Shoqërinë; c. Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; d. Të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, 	<p style="text-align: center;">ARTICLE 19</p> <p style="text-align: center;">Powers of the Administrator</p> <p>19.1 The Company is represented towards third parties by the Administrator.</p> <p>19.2 The Administrator has the following duties and obligations:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Management the Company's business; b. Representation of the Company; c. Ensuring that the necessary accountancy books and records are kept in a correct and proper manner; d. Preparation and signing of the annual financial statement and consolidated accounts and the

<p>të cilët ia paraqesin Këshillit Mbikëqyrës për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga Asambleja e Përgjithshme;</p> <p>e. Të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që rrezikojnë ekzistencën e shoqërisë;</p> <p>f. Të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve ligjore;</p> <p>g. Të raportojë përpara Këshillit Mbikëqyrës për zbatimin e politikave tregtare;</p> <p>h. Të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme;</p> <p>i. Të zbatojë çdo detyrë tjetër të përcaktuar në ligji dhe në Statut.</p> <p>19.3 Administratori mund të autorizojë me anë të prokurës çdo person të tretë të përfaqësojë Shoqërinë dhe të nënshkruajë çdo dokument, kërkesë apo aplikim në emër dhe për llogari të Shoqërisë.</p>	<p>performance report and their submission to the Supervisory Council for approval together with the proposals for the distribution of profits, which shall then be presented to the General Meeting for approval;</p> <p>e. Creating a monitoring and early warning system with respect to developments threatening the existence of the Company;</p> <p>f. Performing the mandatory registration and publication of the Company data in accordance with the applicable law;</p> <p>g. Reporting to the Supervisory Council on the implementation of business policies;</p> <p>h. Convocation the General Meeting;</p> <p>i. Execution of any other duty stipulated by the law or these Bylaws.</p> <p>19.3 The Administrator may authorize by virtue of a power of attorney any third party to represent the Company and sign any document, request or application in the name and on behalf of the Company.</p>
<p style="text-align: center;">EKSPERTI KONTABËL</p> <p style="text-align: center;">NENI 20</p> <p style="text-align: center;">Ekspertët Kontabël të Autorizuar</p> <p>20.1 Asambleja e Përgjithshme cakton një ose më shumë persona fizikë ose shoqëri si ekspertë kontabël të autorizuar të Shoqërisë.</p> <p>20.2 Eksperti Kontabël i Autorizuar i raporton Këshillit Mbikëqyrës, për çështjet kryesore që rezultojnë nga kontrolli financiar dhe,</p>	<p style="text-align: center;">CHARTERED ACCOUNTANT</p> <p style="text-align: center;">ARTICLE 20</p> <p style="text-align: center;">Chartered Accountant</p> <p>20.1 The General Meeting appoints one or several natural person or companies as the chartered accountant of the Company.</p> <p>20.2 The Chartered Accountant of the Company reports to the Supervisory Council for the main issues resulting</p>

<p>në veçanti, për dobësi të kontrollit të brendshëm në lidhje me procesin e raportimit financiar.</p>	<p>from the financial supervision, in particular in relation to integral audit issues on the financial reporting process.</p>
<p style="text-align: center;">TITULLI V DIVIDENDËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR</p> <p style="text-align: center;">NENI 21 Dividendët</p> <p>21.1 Në përputhje me dispozitat e ligjit, Asambleja e Përgjithshme me një shumicë prej $\frac{3}{4}$ të votave të pranishme në mbledhje mund të deklarojë dividendët në përputhje me të drejtat përkatëse të aksioneve.</p> <p>21.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që u lidhen aksioneve, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me kontributet e paguara për aksionet për të cilat paguhet dividendi dhe në përpjesëtim me shumën e paguar të kontributit për periudhën për të cilën paguhet dividendi. Përjashtimisht, në rastin e aksioneve të emetuara me kushtin që të japin të drejtën për dividend duke filluar nga një datë e caktuar, atëherë dividendi për këto aksione do të paguhet në përputhje me këtë kusht.</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER V DIVIDENDS AND CAPITALIZATION OF THE PROFITS</p> <p style="text-align: center;">ARTICLE 21 Dividends</p> <p>21.1 In compliance with the provision of the law, the General Meeting with a majority of $\frac{3}{4}$ of the voting shares present in the meeting may declare dividends in compliance with the respective rights of the shares.</p> <p>21.2 Unless otherwise provided by the rights conferred to the shares, all dividends are declared and paid in accordance with the contributions paid for the shares for which dividends are paid, and in proportion with the amount of the contribution that was paid for the period for which the dividend is paid. Exceptionally, in case of shares issued under the condition to be entitled to dividend from a predetermined date, then the dividend for such shares shall be paid in compliance with such condition.</p>
<p style="text-align: center;">NENI 22 Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar</p> <p>22.1 Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës Asambleja e Përgjithshme, mund të vendosë të zmadhojë kapitalin e</p>	<p style="text-align: center;">ARTICLE 22 The Capitalization of the Profits</p> <p>22.1 Upon approval of previous year balance-sheets, the General Meeting may decide to increase the registered share capital</p>

<p>Shoqërisë me fitimet e pashpërndara.</p> <p>22.2 Rregullat dhe rregulloret e përcaktuara nga ky statut dhe nga ligji i zbatueshëm për zmadhimin e kapitalit të regjistruar do të zbatohen.</p>	<p>of the Company with the non-distributed dividends.</p> <p>22.2 The rules and regulations determined by these Bylaws and the applicable law on the increase of the share capital shall apply.</p>
<p style="text-align: center;">TITULLI VI</p> <p style="text-align: center;">PRISHJA, LIKUIDIMI DHE NJOFTIMET</p> <p style="text-align: center;">NENI 23</p> <p style="text-align: center;">Prishja dhe likuidimi</p> <p>23.1 Shoqëria mund të priset nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e votave prej $\frac{3}{4}$ të aksioneve me të drejtë vote të pranishme në mbledhjen e thirrur për këtë qëllim dhe, nëse miratohet, do t'i nënshtrohet procedurave të likuidimit.</p> <p>23.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë likuidatorë të cilët do të hartojnë dhe do t'i paraqesin Asamblesë së Përgjithshme raportin përfundimtar mbi aktivet dhe detyrimet e Shoqërisë, dhe mbi procedurat dhe kohën e duhur për likuidimin.</p> <p>23.3 Në përfundim të procedurave të likuidimit, Asambleja e Përgjithshme do të vendosë mbi bilancin përfundimtar, punën e kryer nga likuiduesit dhe përfundimit e procesit të likuidimit.</p> <p>23.4 Pas shlyerjes së kreditorëve të Shoqërisë, likuiduesi do t'u shpërndajë aksionarëve aktivet e mbetura në përpjesëtim me aksionet që ata zotërojnë.</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER VI</p> <p style="text-align: center;">DISSOLUTION, LIQUIDATION AND NOTIFICATIONS</p> <p style="text-align: center;">ARTICLE 23</p> <p style="text-align: center;">Dissolution and Liquidation</p> <p>23.1 The Company may be dissolved by the General Meeting with a majority vote of $\frac{3}{4}$ of the voting shares present in the meeting convoked for such purpose, and, if so approve, it shall be subject to liquidation proceedings.</p> <p>23.2 The General Meeting shall appoint one or more liquidators for administering the liquidation process, who shall prepare and submit to the General Assembly the liquidation report on the actives and obligations of the Company, on the liquidation procedure and the due time for liquidation.</p> <p>23.3 Upon termination of the liquidation procedure, the General Meeting shall resolve on the final financial statement, the work performed by the liquidators and termination of the liquidation procedure.</p> <p>23.4 Following the payment of creditors of the Company, the liquidator shall distribute to the shareholders the remaining actives in proportion with their shares.</p>

<p style="text-align: center;">NENI 24 Njoftimet</p> <p>24.1 Shoqëria mund të njoftojë një aksionar personalisht ose duke i dërguar letër rekomande me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të aksionarit ose në adresën apo postën elektronike e cila i është njoftuar Shoqërisë nga aksionari.</p> <p>24.2 Kur ka disa bashkëzotërues të një aksioni, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me ligjin.</p> <p>Aksionari i vetëm i shoqërisë:</p> <p><i>Alban J. Ahmeti</i></p> <hr/> <p>Datë: 19.12.2018</p>	<p style="text-align: center;">ARTICLE 24 Notifications</p> <p>24.1 The Company may notify the shareholders personally or by sending a registered mail at the registered address of the shareholder, or at the email address notified to the Company by the respective shareholder.</p> <p>24.2 In case of joint owners of a share, the notification should be sent to their representative in compliance the law.</p> <p>Sole shareholder of the Company</p> <p><i>Alban J. Ahmeti</i></p> <hr/> <p>Dated, 19.12.2018</p>



Alban J. Ahmeti